



Në bazë të nenit 16, 17 të Ligjit për Ndërmarrjet Publike Nr.03/L-087, neni 3, pika 1 të Udhëzimit Administrativ Nr. 03/2009 për mënyrën e përfaqësimit të komunave në bordet e drejtorëve të ndërmarrjeve publike lokale, Komisioni Komunal i Aksionarëve i Ndërmarrjes Publike Lokale "Higjiena" Sh.A., në mbledhjen e mbajtur me datë 25/09/2025, ka vendosur të shpall këtë:

KONKURS

Për zgjedhjen e katër (4) anëtarëve të Bordit të Drejtorëve për Ndërmarrjen Publike Lokale NPL "Higjiena" Sh.A.

Mandati i anëtarëve të bordit është në kohëzgjatje prej tri (3) viteve.

DETYRAT DHE PËRGJEGJËSITË

FUNKSIONET E DREJTORËVE; Bordi i Drejtorëve do të;

- a) Respektoi statutin dhe ligjet dhe aktet nënligjore të Ndërmarrjes, dhe të zbatojnë vendimet e aksionarëve;
- b) Definojë strategjinë e korporatës, të aprovoi planin vjetor afarist dhe buxhetin vjetor të përgatitur nga Kryeshefi Ekzekutiv në bazë të udhëzimeve strategjike të Bordit të Drejtorëve;
- c) Siguroi që bilanci i gjendjes dhe pasqyrat financiare të kompanisë janë të përgatitura dhe t'i dorëzojë ato në Mbledhjen e Përgjithshme të aksionarëve për aprovim përfundimtarë, bashkë me një propozim për ndarjen e investimeve;
- d) Siguroi që Librat e kompanisë, duke përfshirë edhe regjistrat financiare, janë në pajtim me standardet e zbatueshme kontabël dhe me ligje;
- e) Sigurojë që auditimi i librave dhe regjistrave të bëhet së paku një herë në vit nga ana e auditorit të pavarur, dhe të dorëzohet raporti i auditimit në Mbledhjen e përgjithshme të aksionarëve si dhe t'i vendoset në dispozicion secilit drejtor dhe zyrtar të kompanisë:

- f) Të bëhen të gjitha arkivimet, publikimet dhe/ose shpalosjet e nevojshme te autoritetet e duhura siç mund të kërkohe me ligj dhe me ligjet anësore të Ndërmarrjes Publike Lokale "HIGJIENA" SH.A., dhe të sigurohet që kompania i zbaton ligjet e zbatueshme dhe standardet e kontabilitetit:
- g) Të hartohet një raport vjetor, në fund të secilit vit biznesor, mbi menaxhimin e ndërmarrjes, pasuritë e Ndërmarrjes, gjendjen financiare të ndërmarrjes dhe politikat afariste të Ndërmarrjes i nënshkruar nga kryetari i Bordit dhe nga më së paku një drejtor tjetër dhe tu shpërndahet të gjithë drejtorëve, zyrtarëve dhe aksionarëve:
- h) Të përgatitet plani afatgjatë strategjik dhe i investimeve si dhe plani financiar i kompanisë dhe t'i dorëzohet bashkë me raportin vjetorë në mbledhjen e përgjithshme të aksionarëve:
- i) Të ketë autoritetin për të krijuar komisione që përbëhen nga individët të cilët janë apo nuk janë duke shërbyer në bordin e drejtorëve, për ta caktuar anëtarin e tyre dhe për të deleguar autoritetin te ato komisione:
- j) Të caktojë, heq, angazhojë dhe largojë zyrtarët e ndërmarrjes, të përcaktojë kompensime për zyrtarët, monitorojë punët e tyre, dhe të lëshojë instruksione:

KUALIFIKIMET DHE PËRGADITJA PROFESIONALE

- Të jetë person që ka integritet, të mos ketë çfarëdo shkelje fiduciare ndaj personave tjerë fizik dhe juridik;
- Të ketë përgatitje të lartë shkollore;
- Të ketë së paku pesë (5) vite përvojë - së paku në një nivel të lartë të menaxhmentit - në fushën e administrimit të biznesit, financave korporative, financa, menaxhim i thesari, banka, konsulencë në biznes ose industri ose nga një fushë tjetër e shkencës ose njohurisë e cila ka të bëjë me veprimtarinë afariste të NP-së; ose (ii) për së paku pesë (5) vite, të ketë qenë kontabilist publik, jurist i kualifikuar, ose anëtar i kualifikuar i një profesioni tjetër i cili ndërlidhet ngushtë me veprimtarinë afariste të NP-së.

KUSHTET

Kandidatët kanë të drejt të zgjedhën në bordet e NPL-së nëse:

- Nuk kanë qenë të dënuar dhe nuk janë nën hetime nga ndonjë gjykatë kompetente;
- Nuk kanë shkelur Kodin e Etikes apo standardet e sjelljes profesionale, përveç nëse një dënim i tillë është ndryshuar nga gjykata ose nga ndonjë organ tjetër i ankesave;
- Nuk ka bërë përgënjeshttrimin e materialit nën çfarëdo dëshmie nën betim, nuk ka qenë në poste menaxheriale në ndonjë kompani që ka falimentuar në 10 vitet e fundit.

Kandidatët nuk mund të zgjidhen në bordet e NPL-së nëse:

- Aktualisht është zyrtar, menaxher i ndërmarrjes përkatëse ose cilëndo nga filialet e saj, ose ka shërbyer si menaxher i ndërmarrjes publike përkatëse ose cilëndo nga filialet e saj 5 vitet e fundit;
- Aktualisht është punonjës i nivelit të lartë i NP-së përkatëse, ose ka shërbyer si punonjës i nivelit të lartë në NP-në përkatëse brenda tri (3) viteve të kaluara;
- Aktualisht ka, ose gjatë tri viteve të kaluara ka pasur çfarëdo marrëdhënie materialo- afariste (përveç si konsumator individual i shërbimit të Ndërmarrjes Publike) me Ndërmarrjen Publike përkatëse, ose cilëndo nga filialet, qoftë në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë;
- Është aksionar, drejtor, zyrtar ose punonjës i lartë në ndonjë shoqëri tregtare ose person tjetër juridik i cili ka marrëdhënie materiale afariste me NP përkatëse ose cilëndo nga filialet e saj;
- Pranon ose ka pranuar brenda tri viteve të kaluara, kompensim shtesë nga NP përkatëse ose cilëndo nga filialet e saj (përveç honorarit të drejtorit ose kompensimin stimulues të përcaktuar në nenin 20.1 Ligjit të Ndërmarrjet Publike, ose anëtar në skemën pensionale të NP përkatëse ose cilëndo nga filialet e saj;
- Përfaqëson një aksionar i cili posedon dhjetë përqind (10%) të aksioneve votuese në NP përkatëse;
- Ka shërbyer në bordin e drejtorëve të NP përkatëse më shumë se nëntë (9) vite nga zgjedhja e parë të tij/saj;

- Është i afërt i shkallës së tretë (siç është konstatuar në përputhje me përkufizimin e 'Interesit Financiar' në nenin 2 të këtij ligji) i cilitdo person që i takon cilësdo nga kategoritë e më sipër;
- Është zyrtar, drejtor ose aksionar ose ka interes Financiar, në shoqëri tregtare të palistuar dhe që konkurren në ndërmarrjen, ose menaxher i lartë, zyrtar, drejtor ose aksionar (i cili posedon më shumë se 2% të të drejtave të votimit) ose ka interes të konsiderueshëm Financiar në cilëndo nga shoqëritë tregtare të listuar që konkurrojnë në Ndërmarrje;
- Është ose në çfarëdo kohë gjatë periudhës 36 muajsh para datës së aplikimit ka qenë zyrtar i zgjedhur publik, i emëruar politik, bartës i një posti udhëheqës ose vendimmarrës në një parti politike;
- Ka çfarëdo konflikti të interesit që për nga natyra, do të shkaktohet që ky person të mos jetë në gjendje që në mënyre rutinore, me besnikëri, në mënyrë të pavarur dhe objektive t'i përmbush detyrat e tij fiduciare ndaj Aksionarëve në NP.

DOKUMENTET E KËRKUARA

- CV-në;
- Letër motivuese;
- Deklaratë nën betim (formular që plotësohet në momentin e dorëzimit të dokumentacionit);
- Dëshmitë e kualifikimit profesional;
- Dëshmitë mbi përvojën e punës;
- Certifikatën që nuk është nën hetime;
- Kopjen e dokumentit identifikues.

Aplikuesi duhet të përgatitë deklaratën nën betim, në të cilën deklaron që ai/ajo i përmbush kushtet e kualifikimit, pavarësinë dhe përgatitjen profesionale.

Çdo informatë e pavërtetë materiale, qoftë e qëllimshme, qoftë nga neglizhenca, do të rezultojë më diskualifikim të menjëhershëm.

Formularët e aplikimit mund të sigurohen në Zyrën e Informacionit në objektin qendror të Komunës së Deçanit, në web-faqen zyrtare të Komunës <https://kk.rks-gov.net/decan/>, në Ndërmarrjen Publike Lokale NPL "Higjiëna" Sh.A.

Dokumentacioni i kompletuar duhet të dorëzohet në zarf të mbyllur në zyrën pritëse (Kati i I-rë) të Komunës së Deçanit.

Vëmendje: Të gjitha dokumentacionet e dorëzuara në zarf të hapur nuk do të merren në shqyrtim dhe do të konsiderohen të pavlefshme.

Vërejtje:

Dokumentacioni dorëzohet në kopje, origjinali duhet të prezantohet gjatë intervistimit. Vetëm kandidatët të cilët i plotësojnë kriteret sipas këtij konkursi do të kualifikohen për fazat e mëtejshme.

Afati i aplikimit është i hapur 30 ditë kalendrike pas publikimit të shpalljes publike duke filluar nga data: **25/09/2025** deri më **25/10/2025**, në ora 16:00.

